



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT

Nr. 159/5 prot.

Tiranë, më 03.10.2025

URDHËR

Nr. 119, Datë 03/10 2025

PËR

**“NDRYSHIMIN E URDHËRIT NR. 159/3 PROT., NR. 68, DATË 20.06.2025
“MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË INSPEKTIMIT TË VEPRIMTARISË SË
PËRMBARUESVE GJYQËSORË SHTETËRORË””**

Në zbatim të nenit 8, pika c të Ligjit nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, si dhe në kuadër të përmirësimit të efikasitetit të procedurave të inspektimit të veprimtarisë përmbarimore të Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror,

URDHËROJ

1. Ndryshimin e Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 “Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë”.
2. Pikës 1 të këtij urdhri me përmbajtjen: “Miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë”, i shtohet përmbajtja si vijon:

“sipas tekstit dhe shtojcave që i bashkëngjitet këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit, kryetarët e zyrave vendore përmbarimore dhe përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë për zbatimin e këtij urdhri.
4. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse, për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ERGYS QIRICI



SHTOJCA

Shtojca 1. Vendim për miratimin e planit vjetor të inspektimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 202__

VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/202__

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË INSPEKTIMEVE”

Në zbatim të nenit 8, pika c të Ligjit nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 “Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

(1. Në kuadër të vijimit të procedurave të inspektimit..)

VENDOSA:

1. Miratimin e planit vjetor të inspektimit që do të kryhet nga Drejtoria e Inspektimit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

(Emri e Mbiemri)

Shtojca 2. Vendim për miratimin e inspektimit (tema/lloji)



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT**

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____. _____. 202__

VENDIM

Nr. _____, Datë ____/____/202__

**“PËR
MIRATIMIN E INSPEKTIMIT “LLOJI DHE TITULLI I INSPEKTIMIT”**

Në zbatim të nenit 8, pika c të Ligjit nr. 8/2023 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror”, Urdhrit nr. 159/3 Prot., nr. 68, datë 20.06.2025 “Për miratimin e Metodologjisë së Inspektimit të Veprimtarisë së Përmbaruesve Gjyqësorë Shtetërorë”, i ndryshuar, Vendimit nr. Prot., nr., datë “Për miratimin e planit vjetor të inspektimeve”,

VENDOSA:

1. Miratimin e inspektimit “Lloji dhe Titulli i inspektimit”, që do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Përmbarimit, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Inspektimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse për njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

(Emri e Mbiemri)

Shtojca 3. Njoftim për miratimin e vendimit të inspektimit nr. __ Prot., nr. __, datë __. __. 202__
"Lloji i inspektimit dhe tematikat e inspektimit", të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT

Tiranë, më __. __. 202__

Nr. __ prot.

Lënda: Njoftim për miratimin e vendimit të inspektimit nr. __, datë __. __. 202__
"Lloji i inspektimit dhe tematika e inspektimit" të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit.

ZYRËS VENDORE PËRMBARIMORE TË CILËS I DËRGOHET
(Qyteti)

Në vijim të miratimit të vendimit nr. __, datë __. __. 202__, "Lloji dhe tematika e inspektimit", të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, ju njoftojmë mbi zhvillimin e inspektimit tematik/institucional pranë Zyrës Përmbarimore ____.

Inspektimi "Lloji dhe tematika e inspektimit" ka si qëllim/objekt (përshkrimi dhe qëllimi i objektit të inspektimit) dhe do të kryhet nga anëtarët e grupit të inspektimit (emrat e anëtarëve të grupit të inspektimit).

Gjatë procesit të inspektimit do të trajtohen të dhënat dhe do të shqyrtohen aktet (përcaktimi i akteve që do të shqyrtohen në varësi të inspektimit), si dhe çdo e dhënë tjetër në kuadër të realizimit të inspektimit.

Inspektimi do të zgjasë nga data __. __. 202__ deri në datën __. __. 202__.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
(Emri e Mbiemri)

ISTRIA



Tiranë, më202

INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME MBI RAPORTIN

Titulli:

Raporti i inspektimit "TITULLI/LLOJI I INSPEKTIMIT"

Data e paraqitjes:

DD/MM/VVVV

Përgatitur nga:

Grupi i inspektimit

z./znj. (Emri e Mbiemri i Inspektorit/Inspektorëve që punuan raportin)

Pranuar nga:

Drejtor i Inspektimit

z./ znj. (Emri e Mbiemri i Drejtorit të Inspektimit)

Për shqyrtim nga:

Drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit

z. (Emri e Mbiemri i titullarit)

Miratoi ☐ Ndryshoi Ktheu ☐

Datë ____/____/____

RUBRIKAT E RAPORTIT TË INSPEKTIMIT

I. Pjesa hyrëse

Në këtë pjesë të raportit, grupi i inspektimit, pasqyron të dhënat themelore që lidhen me:

- aktin e shpalljes së vendimit për fillimin e inspektimit;
- përbërjen e grupit të inspektimit;
- arsyet e ndërmarrjes së inspektimit;
- bazën ligjore mbi të cilën mbështetet procesi;
- periudhën kohore të zhvillimit të inspektimit;
- zyrën vendore përmbartimore, kryetarin dhe përmbartuesit subjekt inspektimi;
- objektivat e përcaktuara të procesit të inspektimit.

Gjithashtu, në këtë pjesë përfshihen edhe përmbledhjet hyrëse, konkluzionet paraprake dhe rekomandimet kryesore të raportit, sipas parashikimeve në pikën 3.3 të Metodologjisë të Inspektimit.

II. Objekti i kontrollit dhe analiza ligjore

Në këtë seksion përcaktohen të dhënat që lidhen me objektin e inspektimit si dhe të gjitha veprimet e kryera nga grupi i inspektimit, të cilat ndahen në këto kategori:

- faktet e konstatuara në lidhje me veprimtarinë administrative të subjektit të inspektimit;
- faktet e evidentuara nga shqyrtimi i veprimtarisë procedurale i çështjeve objekt inspektimi;
- çdo element tjetër me rëndësi thelbësore në kuadër të procesit të inspektimit.

Pasi evidentohen të gjitha elementët e përmendur më sipër, si dhe përshkrimi i çështjeve të kontrolluara dhe analiza ligjore, sipas pikës 3.3 të Metodologjisë së Inspektimit, grupi i inspektimit analizon ligjshmërinë dhe besueshmërinë e informacionit të administruar, duke hartuar një relacion specifik për secilën prej tyre.

III. Gjetjet e inspektimit

Në këtë seksion, pas shqyrtimit dhe administrimit të materialeve, grupi i inspektimit parashton gjetjet e konstatuara gjatë procesit të inspektimit.

IV. Konkluzionet

Bazuar në të dhënat e mbledhura dhe analizën e kryer, grupi i inspektimit harton konkluzionet lidhur me zhvillimin e gjithë procesit të inspektimit, duke përmendur zhvillimin e të gjitha fazave të procesit të inspektimit, problematikave dhe vështirësive që ka hasur gjatë kryerjes së inspektimit, evidentimit të shkeljeve, evidentimin e praktikave më të mira të punës, si edhe çdo të dhënë tjetër, e cila pasqyrohet në raportin e inspektimit.

V. Rekomandimet

Në përfundim të raportit, grupi i inspektimit harton rekomandime të qarta dhe të argumentuara për zyrat vendore, kryetarët dhe përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë të inspektuar, me qëllim përmirësimin e veprimtarisë së tyre, si dhe për standardizimin dhe rritjen e efektivitetit të proceseve që i shërbejnë zbatimit të ligjshmërisë në veprimtarinë e përmbarimit gjyqësor shtetëror.

Në rastet kur nga inspektimi evidentohen shkelje ligjore, grupi i inspektimit propozon, sipas rastit, fillimin e hetimit disiplinor, në bazë të Ligjit nr. 8/2023 *"Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror"*.